

VENDIM
Nr. 279, datë 13.4.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 23, DATË 20.1.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PUNONJËSIT ME KONTRATË TË PËRKOZHSHME PËR VITIN 2016 NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 23, datë 20.1.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, të vendimit, numri i punonjësve dhe praktikantëve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet "...1 867 veta ...".
 2. Në lidhjen nr. 1 të përmendur në pikën 1, të vendimit, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
 - a) Në ndarjet "Gr. 3 Kryeministria", "Gr. 94 Ministria e Zhvillimit Urban" dhe "Gr. 14 Ministria e Drejtësisë" shtohet ndarja sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij;
 - b) Emërtesa "sanitar" në Gjykatën e Krimeve të Rënda, zëvendësohet me emërtesën "sekretar gjyqësor".
 3. Në lidhjen nr. 2, të përmendur në pikën 1, të vendimit, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
 - a) Në ndarjen nr. 3, "Kryeministria", numri i punonjësve (praktikantë) ndryshon dhe bëhet 14 specialistë;
 - b) Pas ndarjes nr. 17 shtohet ndarja nr. 20, "Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave", sipas tabelës nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
 4. Në pikën 4, të vendimit, pas fjalëve "... të cilët merren me anketime të ndryshme të Institutit të Statistikave..." shtohen fjalët "... dhe Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave...".
 5. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë pas hyrjes së tij në fuqi dhe përballohen nga buxheti i miratuar për institucionet e përmendura në këtë vendim. Përfundimisht, për praktikantët e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, efektet financiare fillojnë nga momenti i lidhjes së kontratës.
 6. Ngarkohen institucionet e përmendura në pikat 1 dhe 2 të vendimit, dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Tabela nr.1

Gr.	Emri i Institucionit	Nr. Punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
03	Kryeministria	12			
	Aparati i Kryeministrit	2	Specialistë	6 orë/ ditë	Prill-Dhjetor
	Departamenti i Administratës Tatimore	10	Specialistë	6 orë/ ditë	Prill-Dhjetor
14	Ministria e Drejtësisë	3			
	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës	1	Sanitar	5 orë/ditë	Prill-Dhjetor
	Instituti i Mjeksisë Ligjore	2	laburant/ndihmës prozektor	5 orë/ditë	Prill-Dhjetor
94	Ministria e Zhvillimit Urban	101			
	Aparati i ministrisë	1	Specialist arkiv/protokoll	6 orë/ditë	Prill-Dhjetor
	Drejtorite Rajonale te ALUIZNI-t	74	Specialistë	8 orë / ditë	Prill-Dhjetor
	Drejtorite Rajonale te ALUIZNI-t	26	Teknikë	8 orë / ditë	Prill-Dhjetor
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	116			

Tabela nr.2

Kodi	Emri i institucionit	Numri i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	2	Specialist	8 orë/ ditë	Janar-nëntor